



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 08 Mars 2021

Nr: 116

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË BERAT, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË  
SHQIPËRISË, ZJ. MALVA SYRJA ALIAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ

Me shkresën nr. 805 prot., datë 10.02.2021, këshilli i bashkisë Berat, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës nga këshilltari zj. Zegjine Mustafa Lika, propozuar nga subjekti partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e partisë Socialiste e Shqipërisë, është kandidati me numër rendor 39, zj. Malva Syrja Aliaj.

Me shkresën nr. 1246 prot., datë 16.02.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Berat, zj. Malva Syrja Aliaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 010 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, zj. Malva Syrja Aliaj, në këshillin e bashkisë Berat, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 1391 prot., datë 22.02.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1390 prot., datë 22.02.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, zj. Malva Syrja Aliaj, në këshillin e bashkisë Berat, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Berat, zj. Malva Syrja Aliaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 1949/1 prot., datë 24.02.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Malva Syrja Aliaj, në këshillin e bashkisë Berat, e cili rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Referuar pika 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se, të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Malva Syrja Aliaj, në këshillin e bashkisë Berat, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

## **PËR KËTO ARSYE:**



Data: 08 Mars 2021

Nr. 116

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Berat, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, zj. Malva Syrja Aliaj.

Bazuar në bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

### **V E N D O S:**

1. Zj. Malva Syrja Aliaj, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Berat, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Berat, me kandidatin nga lista shumemërore e partisë Socialiste e Shqipërisë, zj. Malva Syrja Aliaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 08 Mars 2021

Nr. 116

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Berat, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, zj. Malva Syrja Aliaj.